

DKR.P.nr.11/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA NË PEJË, Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari, Sylë Lokaj, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Binake Mulliqi, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PP.nr.133/2018, të dt.06.02.2019, kundër të akuzuarit I. G., për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 302 par 2 të KPK-së, pas mbajtjes së seancës fillestare në prezencën e Prokurorit të Shtetit Valbona Disha- Haxhosaj, e dëmtuara D. G., të akuzuarit, me dt. **12.03.2019**, mur dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: **I. G.**, i biri i M. dhe Miradije e gjinisë H., i lindur me ka të kryer shkollën fillore, i gjendje se mesme ekonomike, i pa martuar, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës , i pa gjykuar me parë, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

- Për shkak se

Me dt.21.11.2018, rrethe orës 18:30, në Rr. “...”, Klinë, në lokalitë të kozmetikës “:I.:”, ka poseduar parane të falsifikuara me qëllim që të njëjtën ta vejnë në qarkullim si të vërtetë dhe atë monedhën në vlerë prej 100 euro, me nr. serik, në atë mënyrë që i pandehuri shkon në kozmetiken “ “I.” ”, për të blerë një parfum me vlerë prej 6.80 euro, dhe të dëmtuarës ja jep monedhën në vlerë prej 1X100 euro, e pastaj e dëmtuara ia kthen shumën tjetër të parave në vlerë prej 93.20 euro, me çrresshtë e dëmtuara edhe pse fillimisht dyshon në monedhën në fjalë , por nuk e njofton policinë dhe pas tri dite pasi përgatit pazarin për ta deponuar në bankë prapë dyshon në monedhën e dorëzuar nga i pandehuri e atëherë e raporton rastin në polici , monedha e dyshuar pas ekzaminimit ka rezultuar totalisht e falsifikuar.

-me çka ka kryer veprë penale falsifikim i parasë nga neni 302 par 2 të KPK-së.

Për këtë gjykata në kuptim të nenit 17, 21 par.2 , 45 par.2, 50, 51, 52, 53, 69, 73, 74, 75 par.1 pika 1.2, 76 par.1 pika1.3, e lidhur me nenin 302 par.2 të KPK-së, dhe nenit 365 e 366 të KPPK-së, të akuzuarin e :

G J Y K O N

1.Me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej tre (3) muaj.

Dënimi me burg , fare nuk ka për tu ekzekutua, me kushtë qe i akuzuari ne afat prej 1 viti nuk do te kryen vepër te re penale .

2. Dënim plotësues , konfiskimi i një monedhë prej 100 euro, me nr. serik P32855062735, e cila pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi ka për tu asgjësua.

I akuzuari detyrohet qe gjykatës ne emër te paushallit gjyqësorë te ja paguaj shumen prej 25 euro.

E dëmtuara D. G. nga fshati Stupel K. Klinë, për realizimin e kërkesës për dëmshpërblim udhëzohet ne kontest civil.

Te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh , pasi qe aktgjykimi te merre formën e prere.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Renda në Pejë, me aktakuzën PP.nr.133/2018, të dt.06.02.2019, e ka akuzuar I. G., për veprën penale falsifikim i parasë nga neni 302 par 2 të KPK-së.

Në shqyrtim fillestar Prokurori i Shtetit Valbona Disha- Haxhosaj , ka mbetë në tersi pranë aktakuzës, kualifikimit të njëjtë juridik për veprën penale.

I akuzuari I. G. , që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranua fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet.

Prokurorja e Shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

E dëmtuara D. G. është pajtua me pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Meqenëse i akuzuari që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranua fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, Prokurorja e Shtetit, është pajtua me pranimin e fajësisë, Kryetari i trupit gjykues është bind se i akuzuari i ka kuptua pasojat dhe privilegjet e pranimit te fajësisë, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat në shkresa te lëndës, raporti policor nr.2018-DE-508, të dt. 13.12.2018, vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm te sendeve me numër te njëjtë te dt.13.12.2018, aktakuza nuk përbën ndonjë shkelje të qartë ligjore. Për këtë gjykata gjen se janë plotësua kërkesat e parapara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, andaj në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPK-së, e ka pranua pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngase provat në shkresat e lëndës, vërtetojnë se i akuzuari ditën, kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale: falsifikim i parasë nga neni 302 par 2 të KPK-së. Për këtë gjykata të akuzuarin e ka shpallë fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Prokurorja e shtetit Valbona Disha – Haxhosaj , lidhur për dënimin tha: për të akuzuarin nuk ka rrethana renduese, ashtu që edhe sikur ti shqiptohet një dënim më i butë, do të arrihej qëllimi i ndëshkimit, propozoj që i akuzuari të detyrohet në kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe ati ti shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i kartëmonedhës së falsifikuar.

E dëmtuara lidhur për dënimin tha: ndjekjen penale ja lë në kompetencë Prokurorit, ndërkaq nuk kërkoi dëmshpërblim.

I akuzuari I. G. , lidhur për dënimin tha: e ndije veten fajtor jam i penduar thellë, dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet e tilla kërkoi nga gjykata të më liroi nga dënimi.

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të cilat kishin për të ndikua në llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese gjykata nuk ka gjetur te i akuzuari. Ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, ai nuk ka qenë dënuar më parë, e posaçërisht faktin se i akuzuari që në fillim të shqyrtimit gjyqësor në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzua.

Duke pasur parasysh edhe këto rrethana, gjykata duke aplikuar zbutjen e dënimit brenda kufijve të lejuar paraprë me nenin 75 par 1 pika 1.2 e lidhur me nenin 76 par.1 pika 1.3 të KPK-së, të akuzuarin e ka gjykuar me dënim të kushtëzuar burgimi në kohëzgjatje prej tre muaj , në kuptim të dispozitave të nenit 51,52 par 2 të KPK-së, është vendosur që dënimi me burg fare të mos ekzekutohet me kushte që i akuzuari në afat prej një viti, nuk do të kryen veprë të re penale. Kështu është vendosur me bindje të thellë se edhe një dënim i tillë i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, dhe se i njëjti dënim do të ndikojë dukshëm në sjelljet e të akuzuarit në të ardhmen , me çka do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraprë me nenin 41 të KPK-se.

Vendimi për dënimin plotësues konfiskimi i monedhës që ka qenë objekt në kryerjen e veprës penale është i bazuar në nenin 69 par 3 të KPK-së .

Vendimi që i akuzuari të ja kompensojë gjykatës shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450 par. 2 pika 2 dhe 6 të KPPK-së, me bindje se i akuzuari i ka kushtet për përmbarim.

Palët e dëmtuara nuk kane paraqitur kërkesë pronëso-ro-juridike, por e kanë paralajmëruar se një kërkesë te tillë do te paraqesin ne një kontest te rregullt civil, andaj gjykata bazuar ne nenin 463 par 1 dhe 2 te KPPK-së, te dëmtuaren e ka udhëzuar ne kontest civil.

Nga sa u tha me lartë, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

U VENDOS NE GJYKATEN THEMELORE – Departamenti për Krime te Rënda në Pejë, me dt.12.03.2019.

P.nr. 11/2019

Sekretarja Juridike
Binake Mulliqi

Kryetari i Trupit Gjykes - Gjyqtari
Sylë Lokaj

UDHZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh , pas marrjes, Gjykatës së Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.